

STRUKTURA E SHKOLLIMIT TË DETYRUESHËM

Shkollimi i detyrueshëm ndahet në tri cikle (tri etapa):

- **Cikli 1** : Nga viti i 1^{re} deri në vitin e 4^{te} (nxënësit nga 4 deri në 8 vjeç)
- **Cikli 2** : Nga viti i 5^{te} deri në vitin e 8^{te} (nxënësit nga 8 deri në 12 vjeç)
- **Cikli 3** : Nga viti i 9^{te} deri në vitin e 11^{te} (nxënësit nga 12 deri në 15 vjeç)



KONTEKSTI ROMAND

Të gjitha kantonet e Zvicrës romande kanë pranuar **Konventën shkollore romande**. Kjo konventë u mundëson kantoneve që të punojnë sëbashku për:

- > përcaktimin e planit të studimeve,
- > hartimin e mjeteve mësimore (librave shkollore),
- > organizimin e shkollimit,
- > Formimin e mësuesve.

>>> Më shumë informacione në sitin: www.ciip.ch

KONTEKSTI KOMBËTAR DHE NDËRKANTONAL

Shumica e kantoneve zvicerane e kanë miratuar **Marrëveshjen ndërkantonale mbi harmonizimin e shkollimit të detyrueshëm** (marrëveshjen HarmoS).

Kjo marrëveshje parashikon pikërisht realizimin e një plani studimesh për çdo rajon gjuhësor. Ajo përcakton gjithashtu organizimin e shkollës me 11 vite dhe e cakton moshën e hyrjes në shkollë në 4 vjeç.

>>> Më shumë informacione në sitin: www.cdip.ch

PERSPEKTIVAT

Për ta vënë në jetë PER-in, kantonet romande hartojnë sëbashku mjete arsimore romande (libra shkollore që përdoren nga të gjitha kantonet dhe material klase). Këto mjete mësimore futen hap pas hapi sipas një kalendari të përcaktuar nga CIIP-i.

>>> Planifikimi i mjeteve mësimore romande gjendet në sitin www.ciip.ch

PLATFORMA E PLANIT ROMAND TË STUDIMEVE

Ju mund ta gjeni PER-in e plotë në linjë. Bëhet fjalë para së gjithash për një mjet për mësueset e mësuesit, prandaj ai përdor një gjuhë të posaçme që u drejtohet punonjësve të arsimit dhe mësimeve. Një fjalorth për shpjegimin e disa termave është në dispozicion.



>>> PER-in në tërësi mund ta gjeni në sitin www.per-mer.ch

 Office de l'école obligatoire et du conseil
Chemin des Lovières 13
2720 Tramelan
T +41 31 636 16 60
www.bkd.be.ch/fr/start.html

 Service de l'enseignement obligatoire de langue française
Rue de l'Hôpital 1
1700 Fribourg
T +41 26 305 12 27
www.fr.ch/dfac/senof

 Direction générale de l'enseignement obligatoire
Chemin de l'Echo 5A
1213 Onex
T +41 22 327 04 00
www.ge.ch/organisation/direction-generale-enseignement-obligatoire

 Service de l'enseignement
Route de Moutier 16
2800 Delémont
T +41 32 420 54 10
www.jura.ch/sen

 Service de l'enseignement obligatoire
Rue de l'Ecluse 67
2002 Neuchâtel
T +41 32 889 69 20
www.ne.ch/autorites/DFDS/SEEO/Pages/accueil.aspx

 Service de l'enseignement
Place de la Planta 1
1950 Sion
T +41 27 606 42 00
www.vs.ch/web/def

 Direction générale de l'enseignement obligatoire et de la pédagogie spécialisée
Rue de la Barre 8
1014 Lausanne
T +41 21 316 32 32
www.vd.ch/def/dgeo

Faubourg de l'Hôpital 68
Case postale 556
CH-2002 Neuchâtel
T +41 32 889 69 72
ciip@ne.ch
www.ciip.ch

ciip:

Conférence intercantonale
instruction publique et culture
Suisse romande et Tessin



Traduction en albanais

Plani romand i studimeve (PER) Dokument informues për prindërit

PER-i përcakton formimet që të gjithë fëmijët duhet të njohin gjatë shkollimit të tyre të detyrueshëm. Ai është ngritur, qysh nga viti 2013, për të gjitha kantonet romande dhe mundëson pasjen e një sistemi edukimi të bashkërenduar në të gjithë rajonin frëngjishtfolës të Zvicrës.

Të dashur Prindër,

Plani romand i studimeve është rezultat i një procesi të gjatë shkëmbimesh dhe konsultimesh midis kantoneve romande për harmonizimin e shkollimit të detyrueshëm.

I miratuar në vitin 2010 dhe i vënë në zbatim hap pas hapi në vitin 2013, PER-i përcakton një projekt global formimi për nxënësin. Ai përshkruan çka nxënësit duhet të mësojnë gjatë shkollimit të tyre të detyrueshëm dhe nivelet që duhet të arrihen në fund të secilit cikël (në fund të vitit të 4^{te}, të 8^{te} e të 11^{te}).

Kantonet dhe trupat mësimore duhet të respektojnë objektivat e përshkruara në PER, por ruajnë një hapësirë manovrimi për sa u përket mjeteve për t'i arritur ato. Kantonet mund të shtojnë formime specifike sipas kulturës së vet.

Kjo fletë ju paraqet disa informacione të përgjithshme për të kuptuar strukturën dhe përmbajtjen e PER-it.

Kjo fletë është përkthyer në disa gjuhë: kontaktoni shërbimin e arsimit të kantonit tuaj për të pasur një përkthim të saj.

Nëse dëshironi më shumë hollësi për çdo cikël në PER, ju mund të konsultoni një broshurë në lidhjen e mëposhtme:

<https://portail.ciip.ch/per/pages/informations-parents/>



Konferenca latine e arsimit të detyrueshëm, qershor 2024



NJË VULLNET POLITIK

Kantonet romande punojnë sëbashku dhe janë rigrupuar në Konferencën ndërkantonale të arsimit publik dhe të kulturës së Zvicrës romande dhe Tiçinos (CIIP). Ato kanë zhvilluar një vizion të përbashkët për shkollën dhe formimin e nxënësve. Në vitin 2003, kantonet miratuan një *Deklaratë mbi qëllimet dhe objektivat e Shkollës publike* që saktëson se:

« Shkolla publike merr përsipër misionin të arsimit dhe transmetimit kulturor pranë të gjithë nxënësve. Ajo siguron ndërtimin e njohurive dhe marrjen e aftësive që i mundësojnë secilit e secilës të zhvillojë në mënyrë optimale potencialet e tij/saj. »

FINALITÉS ET OBJECTIFS

- > Të transmetojë njohuri të nxënësve dhe të zhvillojë aftësitë e tyre në lëndë të ndryshme. >>>
- > Veç arsimit, shkolla ka edhe rol edukativ në partneritet me familjet. Ajo synon transmetimin të fëmijëve të vlerave të shoqërisë. >>>
- > Shkolla kërkon gjithashtu të zhvillojë të nxënësve aftësitë transversale më të përgjithshme që do t'u jenë të dobishme gjatë tërë jetës së tyre. >>>

Pra, bëhet fjalë për një projekt global formimi që synon zhvillimin e nxënësve në tërësinë e tij për të mundur integrimin e tij në shoqëri.

>>> Për më shumë informacione: www.per-mer.ch



Një projekt global formimi

Veprimtaritë e kryera në shkollë përfshihen në projektin global të formimit, të përcaktuar nga Plani romand i studimeve (PER). Ky plan përshkruan formimet që çdo nxënës duhet të kryejë gjatë tërë shkollimit të tij të detyrueshëm.

Fushat lëndore

rigrupojnë lëndët shkollore që jepen në të gjitha kantonet romande Çdo fushë lëndore përmban disa lëndë shkollore që kanë lidhje midis tyre.

GJUHËT

Të dish të komunikosh në disa gjuhë është e domosdoshme në ditët tona. Gjatë shkollimit të vet, nxënësi zhvillon pak nga pak aftësitë e tij në frëngjisht e pastaj në gjermanisht e anglisht.

MATEMATIKA DHE SHKENCAT E NATYRËS

Kuptimi i botës së sotme kërkon njohuri dhe zhvillimin e frymës shkencore. Për këtë qëllim, nxënësi punon me nocione matematikore dhe shkencore, që do t'i mundësojnë zgjidhjen e problemeve teorike dhe përballimin e situatave konkrete

SCIENCES HUMAINES ET SOCIALES

Kuptimi i sfidave të shoqërisë është njëra nga aftësitë që pritet të ketë çdo njeri. Kjo prek përmasat shoqërore, kulturore, ekonomike, politike e mjedisore. Si qytetar i ardhshëm e qytetare e ardhshme, nxënësi/ja merr njohuritë gjeografike, historike dhe qytetare që i mundësojnë pjesëmarrjen në shoqërinë ku ai dhe ajo jetojnë

ARTET

Eksplorimi dhe praktikimi i formave të ndryshme të shprehjes artistike nxit krijimtarinë. Këto lëndë i mundësojnë nxënësit përvetësimin e referencave kulturore dhe zhvillimin e aftësive dhe teknikave artistike që zgjerojnë perceptimin prej tij të botës që e rrethon

TRUPI DHE LËVIZJA

Marrja me sport dhe mësimi i gatimit në mënyrë të shëndetshme dhe të baraspeshuar që bëjnë të mundur që nxënësi të njohë trupin e tij dhe të kujdeset për të. Nxënësit zhvillojnë kështu aftësitë e tyre fizike përmes lëvizjes dhe mësojnë parimet e të ushqyerit të shëndetshëm.

EDUKIMI NUMERIK

Kuptimi i rëndësisë së mjeteve numerike është sot i domosdoshëm për zhvillimin e kulturës numerike. Për këtë, nxënësi zhvillon aftësi teknike dhe mëson si të forcojë frymën e tij kritike përballë informacioneve dhe figurave. Objektivi është përdorimi i mjeteve numerike në mënyrë të efektshme dhe të përgjegjshme.

PLANI ROMAND I STUDIMEVE ËSHTË ORGANIZUAR NË TRI PJESË:

FUSHAT LËNDORE

AFTËSITË
TRANVERSALE


FORMIMI I
PËRGJITHSHËM

Projekti i formimit global punon në të tria këto përmasa gjatë të gjitha viteve të shkollës të detyrueshme.

Formimi i përgjithshëm

Rigrupon tematika të ndryshme që shkolla duhet të ketë parasysh veç mësimi të lëndëve.

Formimi i përgjithshëm trajton njohuri dhe aftësi që nuk rrjedhin vetëm nga lëndët shkollore. Ajo merret me aspekte edukative dhe u mëson nxënësve aftësi thelbësore për të kuptuar botën me të gjitha ndërlikimet e saj, për të ndërtuar argumente dhe për të ruajtur shëndetin e tyre.



Aftësitë transversale

janë aspekte thelbësore për të mësuar mirë. Ato zhvillohen në të gjitha lëndët dhe bëhen për nxënësin mjete të dobishme në formimet e tyre.

Gjatë tërë shkollimit të tij, nxënësi zhvillon aftësi transversale që janë të përbashkëta për të gjitha lëndët dhe për veprimtari të shumta në klasë. Këto aftësi nxënësi nuk i mëson në vetvete, por i merr për shembull duke zgjidhur probleme, duke komunikuar në gjuhë të ndryshme, duke realizuar projekte. Këto aftësi janë të rëndësishme për nxënësin edhe pas mbarimit të shkollës, si për gjetjen e një pune edhe për integrimin në shoqëri.